

Me rastin e Asamblesë së nëntë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Pejë më 11 mars 2010

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë:

Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Gerrit-Marc Sprenger, Anna Bednarek, Arkadiusz Sedek, Charles Smith, Gabriele Gaube, Emilio Gatti, Esma Erterzi, Francesco Florit, Guy Van Craen, Harri Katara, Klaus Jung, Klaus Huner, Johanna Schokkenbroek, Laura Plesa, Nikolay Entchev, Piero Leanza, Richard Winkelhofer, Rositza Buzova, Torsten Koschinka, Vergiinia Micheva-Ruseva, Vitor Pardal, Vladimir Kanev.

Merr VENDIMIN

Njëzëri, mbi miratimin e këtij Rekomandimi mbi kompetencat dhe përbërjen e Kolegjeve në shkallë të Gjykatës Supreme për lëndë të së drejtës civile.

Maria Giuliana Civinini
Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

REKOMANDIM

Duke u mbështetur në Nenin 4.10 të Ligjit Nr. 03/L-053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë – LmK- dhe në Nenin 8 të Rregullave të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Asamblesë

I rekomandohet

Që kolegjet e themeluara në pajtim me Nenin 5.2, fjalia e dytë dhe me Nenin 5.5 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK), të cilat gjykojnë lëndët në kuptim të nenit 5.1 c) të LmK-së në shkallë të Gjykatës Supreme, të jenë të përbëra nga:

1) TRE GJYQTARË PROFESIONALË

- Ankesat e paraqitura kundër vendimeve të gjykatës së qarkut dhe asaj ekonomike, pavarësisht nëse zbatohet Kodi i Procedurës Civile të RSFJ-së (KPC) apo Ligji mbi Procedurën Kontestimore (LPK) dhe pavarësisht nëse mbahet shqyrtimi verbal apo jo.
- Përsëritja e procedurës e kërkuar sipas LPK-së nëse kërkesa u referohet vendimeve të gjykatës së qarkut të shkallës së parë.
- Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nëse kërkesa u referohet vendimeve të formës së prerë të gjykatës komunale, të gjykatës së qarkut dhe të gjykatës ekonomike të qarkut, dhe nëse LPK është ligji i zbatueshëm.
- Revizionet e paraqitura sipas LPK-së kundër vendimeve të ankimuarra të gjykatave të qarkut.
- Vendimet e marra për zgjidhjen e Konflikteve lidhur me kompetencat, pavarësisht nëse zbatohet KPC-ja apo LPK-ja.

2) PESË GJYQTARË PROFESIONALË

- Ankesat e paraqitura sipas Nenit 240.4 të LPK-së lidhur me Përsëritjen e procedurës nëse kërkesa u referohet vendimeve të shkallës së parë të gjykatës së qarkut.
- (nëse "ka mundësi") Kërkesat për Rigjykim/Përsëritje të procedurës të cilat u referohen vendimeve të Gjykatës Supreme pavarësisht nëse zbatohet KPC-ja apo LPK-ja.
- Kërkesat për urdhër Certiorari të paraqitura sipas KPC-së.
- Kërkesat për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitura sipas LPK-së nëse kërkesa u referohet vendimeve të Gjykatës Supreme.
- Rishikimet e paraqitura sipas KPC-së.
- Revizionet e paraqitura sipas LPK-së dhe të cilat u referohen vendimeve të ankimuarra të Gjykatës Supreme.

Aneksi 3.2 i shtuar në Rendin e ditës së Asamblesë së nëntë, është një dokument interpretues dhe njëkohësisht pjesë përbërëse e këtij Rekomandimi.